

Michel Houellebecq

# Thërrmijat elementare

Përktheu nga origjinali frëngjisht:

Edit Dibra



# Bukinist

*pasioni për librat*



Skanderbeg Books

Ky libër është, para së gjithash, historia e një njeriu që jetoi pjesën më të madhe të jetës në Europën Perëndimore, gjatë gjysmës së dytë të shekullit xx. Edhe pse rëndom i vetmuar, herë pas here, ai pati lidhje me njerëz të tjerë. Ai jetoi në kohëra të këqija dhe të pështjelluara. Atdheu ku kishte lindur po shkiste ngadalë, dhe pa kthim, në zonën ekonomike të vendeve mesatarisht të varfër; i kërcënuar nga mjerimi, brezi i tij e çoi jetën në vetmi dhe pikëllim. Ndjenja si, dashuria, dhembshuria dhe vëllazëria njerëzore, kishin firuar; në marrëdhëniet mes tyre, bashkëkohësit e tij ishin më së shumti mospërfillës, madje mizorë.

Në kohën kur u zhduk, Mishel Zherzinski mbahej nga të gjithë si një biolog i shquar, aq sa mendohej vërtet t'i jepej çmimi Nobel; por vlerat e tij të vërteta do të spikasnin ca më vonë. Në epokën kur jetoi Zherzinski, filozofia trajtohej pa kurrfarë vlerë praktike, madje pa ndonjë qëllim të mirëfilltë. Në të vërtetë, vizioni më i përhapur mbi botën, të anëtarët e një shoqërie në një çast të dhënë, përcakton ekonominë, politikën dhe doket e saj.

Mutacionet metafizike – pra, shndërrimet rrënjësore dhe tërësore të vizionit të shumicës së njerëzve – janë të rralla në historinë e njerëzimit. Le të marrim si shembull lindjen e Krishterimit.

Sapo ndodh një mutacion metafizik, ai përhapet pa hasur kurrfarë pengese, bashkë me pasojat e tij ekstreme. Ai trondit, madje në mënyrë të pavullnetshme, sistemet ekonomike e politike, vlerat estetike, hierarkitë shoqërore. Asnjë forcë njerëzore nuk ia pret dot

vrullin – madje asnjë lloj force tjetër, me përjashtim të shfaqjes së një mutacioni tjetër metafizik.

Nuk mund të themi se mutacionet metafizike mësyjnë veçanërisht shoqëritë e dobësuara, gati në prag rrënimi. Kur u shfaq Krishterimi, Perandoria Romake ishte në kulmin e fuqisë së saj; me organizim të përsosur, ajo sundonte gjithë universin e njohur; epërsia e saj teknike dhe ushtarake, ishte e pashoqe; pra nuk kishte asnjë gjasë të flitej për dobësi. Kur u shfaq shkencat moderne, Krishterimi mesjetar përbënte një sistem absolut për njohjen e njeriut dhe të universit; ai ishte baza e qeverisjes së popujve, prodhonte dije dhe vepra, vendoste për paqen dhe luftën; organizonte prodhimin dhe ndarjen e pasurive; por asgjë s'e pengoi të merrte rrokullimën.

Mishel Zherzinski nuk ishte as i pari, as i fundit, dhe as krijuesi i mutacionit të tretë metafizik, më rrënjësori nga shumë këndvështrime, i cili do të hapte siparin e një epoke të re në historinë e njerëzimit; por falë disa rrethanave krejt të veçanta në jetën e tij, ai ishte njëri nga krijuesit e tij më të vetëdijshëm dhe më të kthjellët.

# Bukinist

*pasioni për librat*

Ne jetojmë sot në një mbretëri të re,  
Dhe thurima e rrethanave mbështjell trupat tanë,  
I lan trupat tanë,  
Në një vello gëzimi.  
Atë që të hershmit e hamendësonin ndonjëherë përmes  
muzikës

Ne e ndiejmë prorre në të përditshmen.  
Ajo që për ta i përkiste të paarritshmes dhe absolutes  
Ne na duket gjë e thjeshtë dhe e njohur.  
E prapë, ne nuk i përbuzim ata njerëz;  
Ne e dimë sa i detyrohemi ëndrrave të tyre,  
Ne e dimë se do të ishim një hiç pa mpleksjen e dhimbjes dhe  
gëzimit që mishëron e tyrja histori,  
E dimë që ata ruanin brenda vetes imazhin tonë sa herë i  
kaplonte urrejtja dhe frika, sa herë plandoseshin në terr.  
Sa herë që shkruanin pak e nga pak historinë e tyre.  
Ne e dimë se ata nuk do të ishin, as do të mund të ishin, po të  
mos ushqenin thellë tyre këtë shpresë,  
Madje as nuk do të kishin ekzistuar pa ëndrrën e tyre.  
Tani që jetojmë në dritë,  
Tani që jetojmë buzë burimit të dritës  
Tani që drita i lan trupat tanë,  
I vesh trupat tanë,  
Në një vello gëzimi  
Tani që jemi lumit në anë  
Pasditeve të pasosura

Tani që drita rreth trupave tanë është lëndëzuar,  
Tani që kemi mbërritur në tokën e premtuar  
Duke lënë pas shpine universin e ndarjes